



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 2

Prishtinë, më 20.1.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Salih Salihu, Velimir Rakiq, Emilije Redzepi, Murat Hoxha, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala.

Mungoi : Adem Salihaj, anëtar nga PDK ende nuk është emëruar.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.12.2014,
3. Shqyrtimi i shkresës nga sekretaria e Kuvendit rreth inicimit të procedurës për për zgjedhjen e kandidatit për kryesues të komisionit shqyrtues në Zyrën rregullatore për ujësjellës dhe kanalizim,
4. Shqyrtimi i projektligjit të hartuar nga ish komisioni në legjislaturën e kaluar, rreth Zyrës rregullatore për ujësjellës dhe kanalizim, për procedim të mëtejshëm,
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke shtuar pikën për planin e punës së komisionit për vitin 2015. Gjithashtu komisioni kërkoi që dokumentacioni për mbledhje të shpërndahet në kutiza postare të deputetëve. Kryetari arsyetoi edhe bashkimin e dy pikave të rendit të ditës, ngase kemi të bëjmë me lidhjet e tyre funksionale për ZRRUK.

**2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.12.2014**

**Kryetari i Komisionit** konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur me 26 dhjetor 2014.

### 3. Shqyrtimi i shkresës nga sekretaria e Kuvendit rreth inicimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatit për kryesues të komisionit shqyrtues në Zyrën rregullatore për ujësjellës dhe kanalizim

**Kryetari** njoftoi komisionin se nga sekretari i Kuvendit me date 06.01.2015 ka ardhë një shkresë rreth inicimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatit për Kryesues të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, pasi që kryesuesit të meherthem i ka perfunduar mandati me 15.0.2014 dhe komisioni duhet të propozojë një kandidat për ta plotësuar këtë pozitë.

Sipas nenit 34 pika 2 e Ligjit Nr. 03/L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimit dhe të Mbeturinave,

“Komisioni shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i emëruar nga Kuvendi, një anëtar i emëruar nga Rregullatori dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim.” Sipas këtij Ligji nuk janë të percaktuara procedurat e zgjedhjes së këtij kryesuesi, prandaj ftoi anëtarët e komisionit të deklarohen për mënyrën e zgjedhjes së kandidatit, me ligjin në fuqi apo të pritet miratimi i ligjit të ri përkatësisht projektligjit që është hartuar nga ish komisioni.

**Raif Preteni** drejtor i ZRRUK falënderoi për ftesën dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara, ai konstatoi se ky vend i zbrazët i kryesuesit mund të konsiderohet si jo shumë urgjente ngase nuk ka shumë ankesa, por nëse dëshiron komisioni të veprojë, e ka bazën ligjore në ligjin në fuqi ngase sipas tij mund të zbatohen procedurat që i përshkruan projektligji që është hartuar në ish komisionin parlamentar, të hapet konkursi dhe kështu me radhë.

**Nait Hasani**, ish kryetar i këtij komisioni, sugjeroi ligjin e hartuar në ish komision ngase momentalisht kemi duplikimin e funksionit të drejtorit, ngase ekziston edhe zv. Drejtori në këtë zyre, gjithashtu është më i përshtatshëm për zgjedhjen e kryesuesit të komisionit shqyrtues.

**Haxhi Shala** përkrahu mendimin që të procedohet sipas ligjit të ri i cili do të përshpejtohet për miratim sa më të shpejt, fillimisht të bisedohet edhe me sekretarin e kuvendit.

**Salih Salihu** pasi që u interesua për gjendjen e komisionit shqyrtues nga Drejtori i Zrruk propozoi rishikimin e ligjit të hartuar dhe pastaj procedimin e mëtejshëm sipas rregullores, çka gjithashtu përkrahu edhe **Lahi Brahimaj**.

**Kryetari** propozoi të zgjidhet grupi punës për nismën e hartimit të këtij ligji i cili do të punon me procedurë sa më të përshpejtuar, konform sugjerimeve nga kjo mbledhje : **Kryesues : Murat Hoxha** dhe anëtarët **Haxhi Shala dhe Salih Salihu**. U caktua takimi për ditën e premte.

**Baton Begolli** këshilltar për ujëra në kryeministri, përkrahu Drejtorin e ZRRUK për zgjedhjen sa më të shpejt të këtij kandidati ngase nëse ka ndonjë ankesë për tarifa ujore, problemet shfaqen patjetër për shkak se duhet të mbrohen interesat e konsumatorëve, ai sugjeroi zgjatjen e mandatit kryesuesit ekzistues deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri.

### 4. Plani i punës së komisionit për vitin 2015-sugjerimet për plotësimin e tij

**Kryetari** propozoi zhvillimin e diskutimeve për planin e punës, ndërsa javën e ardhshme miratimin e tij. Ai theksoi se planet e deritashme gjithmonë kanë qenë fleksibile, ngase afatet ndryshojnë dhe nuk përmbahen atyre ose Qeveria ose dalin çështje tjera që ndikojnë në joprecizitet të parashikimeve. Kërkoi të ftohen dy ministrat nga dy fushat, ndërsa deri javën tjetër, ai kërkoi nga anëtarët e komisionit të shtojnë ndonjë propozim, nëse kanë, ndërsa zyrtari nga stafi i komisionit propozoi edhe disa çështje tjera si p.sh. mbikëqyrjen e ligjeve në fuqi etj.

**Kryetari** shtoi se mund të kryej komisioni dy mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, njëra në gjashtëmujorin e parë nga bujqësia dhe tjetra në gjashtëmujorin e dytë nga mjedisi. **Lahi Brahimaj** propozoi interesimin dhe mbikëqyrjen e komisionit rreth ndarjes së subvencioneve nga MB, çka edhe **Salih Salihu** plotësisht arsyetoi këtë kërkesë ngase sivjet janë ndarë 53 milion subvencione, të cilat duhet të shikohen mirë se si shpërndahen në bujqësi për fermerët. **Emilija Rexhepi** potencoi faktin e keqpërdorimeve me subvencione, ndaj arsyetoi kërkesën e komisionit për të ftuar ministrin e bujqësisë fillimisht, pastaj në një takim tjetër ministrin e mjedisit. Pasi që

Kryetari kërkoi nga stafi të interesohet për anëtarin e komisionit nga PDK a do të emërohet apo jo, ajo premtoi se do të angazhohet në këtë drejtim pasi që është në GP të PDK.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga:

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

Kryetari i Komisionit,  
**Fikrim Damka**